

PËRMBLEDHJE: PJESËMARRJA SOCIO-POLITIKE E TË RINJVE NË MAQEDONINË E VERIUT: 2021




Fondacioni për demokraci i Uestminster për herë të tretë ka kryer një hulumtim të thelluar me fokus në të rinjtë. Studimi shqyrton pjesëmarrjen socio-politike të të rinjve, por gjithashtu ofron informacion për pikëpamjet e tyre në kontekstin e pandemisë të KOVID-19. Në këtë dokument të shkurtër mund të gjeni të dhëna kryesore nga sondazhi telefonik dhe disa nga rekomandimet e ekipit të autorëve.

Sondazhi është kryer në një mostër kombëtare të qytetarëve të rinj nga Maqedonia e Veriut (1060 të anketuar) të moshës 15-35 vjeç, nga agjencia kërkimore TIM Institut në muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2021. Mostra përfshin: një mostër hulumtuese kombëtare mbi parimin e përzgjedhjes së rastësishme (1030 të anketuar), dhe një mostër shtesë «përforcuese» (30 të anketuar) për të rinjtë me aftësi të kufizuara.


Gjysma e të rinjve të anketuar (52%)

votojnë rregullisht në të gjitha zgjedhjet në vendin tonë, nga të cilët **një e katërta e tyre (25%)** ndonjëherë e ushtrojnë këtë të drejtë qytetare, **6% nuk votojnë kurrë** dhe 11% nuk kanë të drejtë vote.



Gjysma e të rinjve (**51%**) tregojnë gatishmëri për zgjidhjen e problemeve të caktuara sociale.

Prej tyre, 5% ia dolën vazhdimisht ta zgjidhnin problemin, 23% shpesh ia dolën ta zgjidhnin problemin, 51% ia dolën rrallë, dhe 19% nuk ia dolën kurrë ta zgjidhnin problemin.




WFD

Western Balkans
Democracy Initiative





UK Government



45%

e të anketuarve deklarojnë se vendi ynë do të bëhet anëtar i Bashkimit European, që është 15% **më pak në krahasim** me 2 vite më parë.

Një e treta (**34%**) e të rinjve mendojnë se jemi më larg anëtarësimit në BE krahasuar me këtë periudhë të vitit të kaluar.



Më shumë se gjysma e të rinjve (57%) rrallë ose kurrë nuk i ndjekin dhe nuk tregojnë interes për ngjarjet dhe ndodhitë politike në vend.




nota
2,50

nota
2,45

Të rinjtë japin nota më të ulëta se nota mesatare (3) për të gjithë faktorët e ofruar. Notat më të larta i kanë **institucionet arsimore (2.50) dhe organet studentore dhe shkollat e mesme (2.45).**

22%
e të rinjve kanë qenë
të konsultuar nga
institucionet,




ndërsa **75%**
deri më tani nuk kanë qenë të
përfshirë nga institucionet në
vendimmarrje.

Thujse **8 nga 10** të rinj mendojnë se nuk mund të
ndikojnë fare mbi punën e Qeverisë.

4 nga 10 të rinj janë plotësisht ose mjaft të kënaqur me pozitën
e tyre në shoqëri, ndërsa **6 nga 10** të rinj janë pjesërisht ose
plotësisht të pakënaqur me pozitën e tyre në shoqëri.

Ndikimi negativ nga kriza e KOVID-19 për pothuajse **një
të katërtën** e të rinjve më së shumti i preku aspektet e:
shoqërimit dhe marrëdhënieve, jetës kulturore dhe argëtuese
dhe mirëqenien e familjes.



11% raportuan
vështirësi të shëndetit
mendor për shkak të
pandemisë.



UDHËZUES PËR TË RINJTË

REKOMANDIME:



- Të hartohet një Strategji kombëtare për rininë dhe të përmbushë detyrimet e parashikuara në Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore.
- Të krijohet një asamble kombëtare rinore dhe një organ këshillimor kombëtar si një sistem për pjesëmarrjen e të rinjve. Agjencia për rini dhe sport të sigurojë më shumë financa për punën e sektorit të “rinisë” në raport me buxhetin total.
- Të gjitha pushtetet lokale të krijojnë këshilla rinore lokale dhe të fillojnë përgatitjet për hapjen e qendrave rinore, në bashkëpunim me ARD-në, organizatat rinore dhe aktorë të tjerë.
- Partitë politike të bashkëpunojnë me rininë, të përfshijnë të rinjtë në organet dhe njësitë e tyre dhe të formojnë komisione rinore brenda strukturave të tyre.
- Të garantohet organizimi i nxënësve në çdo shkollë dhe të sigurohet pjesëmarrja e qëndrueshme dhe përfaqësuese të nxënësve të shkollave të mesme nëpërmjet një zgjidhjeje ligjore.
- Të formohen kuvende studentore në të gjitha fakultetet dhe universitetet dhe të marrin mbështetje përkatëse administrative dhe financiare për veprim.
- Të hetohen efektet e pandemisë mbi të rinjtë dhe të miratohen politika të përshtatshme për t'i mbështetur ato dhe për të adresuar keqinformimin.
- Palët e interesuara që punojnë në interes të të rinjve, të kujdesen për aksesueshmërinë në aktivitetet e tyre dhe për të rinjtë me aftësi të kufizuara, si dhe të rinj të tjerë të marginalizuar.
- Organizatat rinore të veprojnë si një nxitës për dukshmërinë dhe për zgjidhjen e çështjeve të të rinjve, veçanërisht ato që u përkasin grupeve të cënueshme.

